



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 08.02.2017

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KRUJË

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Krujë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 75, datë 06.01.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Krujë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorieve bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.
3. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Krujë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.



4. Ngarkohet Bashkia Krujë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
5. Bashkia Krujë, gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, duhet të respektojë të gjitha përcaktimet ligjore sa i përket zonave të mbrojtura arkeologjike, të cilat duhet të evidentohen qartë në hartat përkatëse të planit dhe në rregulloren për zbatimin e tij.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Krujë, përfshirë si më poshtë:
 - Vendim Nr. 4, datë 11.08.1999 i KRRTRSH-së “Për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Krujës”.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA ÇJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENSISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

